



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2025

Shtojca 11

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 23.09.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ANBIM” SHPK, me numër NIPTI **L81618008J**, **Adresa:**
Tirane Tirane Autostrada TR-DR Km1 Zona kadastrale 2679 Numri pasurise
40/55 Tirane.

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-59759-08-28-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjente, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: 1,958,330 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 29.08.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr.47,
datë 01.09.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ANBIM” SHPK, me numër NIPTI L81618008J.

Vlera e ofertuar: 1,562,365 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, me numër NIPTI K42003004T.
Vlera e ofertuar: 1,682,780 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, me numër NIPTI K22218003V.
Vlera e ofertuar: 1,750,000 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë **pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “MURATI D” SHPK, me numër NIPTI K42003004T.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 2.6.b të DST, përkatësisht:

2.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

- a) Në rast kur OE nuk është prodhues ai duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Furnizimi/Bashkëpunimi nga një Distributor i Autorizuar per solucionet dhe detergjentet. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi apo Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo kontraktuesit (Distributor i Autorizuar) si: emer, numer nipti, telefon/fax, e-mail/ website, shoqëruar me:
 - Operatori ekonomik duhet te paraqese (skeda teknike) per te gjithë artikujt e tabelës se mëposhtme, skedat duhet të jenë ne gjuhen shqipe dhe nese jane ne gjuhe te huaj duhet te jene te perkthyer e të noterizuara. Ne skedat teknike duhet te dallohet qarte perputhja e te gjitha karakteristikave (specifikimeve teknike) te kerkuara me produktet e ofruara.

Nr. sipas Preventivit	Emertimi
5	Detergjent neutral dysHEMEJE (bidon 5 lit)
7	Detergjent per xhama dhe kristale (bidon 5 lit)
17	Sapun per larje duarsh (leng) (bidon 5 lit)
19	Detergjent universal (zbardhues) (bidon 5 lit)
20	Sgresante universal (bidon 5 lit)
21	Hipoklorit Kalciumi 55-70 %

b) Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mesipërme (nga një mostër për secilin artikull).

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e AK.
- Cdo mostër e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vëlosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korrespondues me emrin e artikullit.
- **Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara. Nese mostrat nuk janë sipas specifikimeve OE do të skualifikohet.**
- Mosparaqitja e mostrave ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.

KVO konstatoi se: OE “MURATI D” SHPK nuk plotëson specifikimet teknike që AK ka kërkuar në DST për mostrat e paraqitura (nuk plotëson pikën 2.6.b, të kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST). Sqarojmë se mostra e paraqitur me nr.19 *Detergjent universal* (zbardhues) (bidon 5 lit), ka skaduar pasi ka afat përdorimi deri me datë 30.04.2024, kriteret këto të përcaktuara tek specifikimet teknike nga Autoriteti Kontraktor në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**ANBIM**” SHPK, me adresë: Tirane Tirane Autostrada TR-DR Km1 Zona kadastrale 2679 Numri pasurisë 40/55 Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **1,562,365** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Majlinda CARA